



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Dt. 01.07.2024

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 20.1, te Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër identifikimi 632-24-621-2-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-002-221 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-4486, për shkak të një gabimi të pariparueshëm në specifikacionin teknik i cili është bartur edhe në kontratë, me dt.01.07.2024, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

VENDIM
Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

1. Për shkak të një gabimi të pariparueshëm në specifikacionin teknik i cili është bartur edhe në kontratë, Kontrata me numër te prokurimit: 632-24-621-2-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-002-221, dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-4486, me titull : “Ri-Tender-Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme”Lot-23: “Ri-Tender-Transporti i nxënësve në relacionin Molliq,Batushë dhe anasjelltas ”, ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve Hasan Alija B.I., Nivokaz, Gjakovë, **NDËRPRITET ME MARRËVESHJE MES DY PALËVE KONTRAKTUESE.**
2. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës për shkak të një gabimi të pariparueshëm në specifikacionin teknik i cili është bartur edhe në kontratë, në pajtim me nenin 20.1 te Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe rekomandimit të Menaxherit të kontratës kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.
3. Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.
4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e punëdhënësit , ka iniciuar aktivitetin për “Ri-Tender-Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme” Lot-23: “Ri-Tender-Transporti i nxënësve në relacionin Molliq,Batushë dhe anasjelltas ”, ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të shërbimeve Hasan Alija B.I., Nivokaz, Gjakovë, për kryerjen e shërbimeve të kontraktuara sipas Kontratës.

Me qëllim të menaxhimit dhe zbatimit në kohë dhe në mënyrë cilësore të kontratës, Zyrtari Kryesorë Administrativ i Autoritetit Kontraktues – Kryetari i Komunës, me Vendimin e tij 112/02-4530 të dt. 25.03.2024, ka emëruar Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtpërdrejte te Menaxherit te Kontratës, me të drejta dhe obligimet sikurse janë përcaktuar në Vendim.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësive të tija, përmes kërkesës dërguar në rrugë elektronike ne Zyrën e Prokurimit me date 20.06.2023, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së të Prokurimit ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës .

Me date 28.06.2024, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit, ka dorëzuar “Njoftimin për shkëputje me marrëveshje te kontratës” te kryesi i shërbimeve Hasan Alija B.I., Nivokaz, Gjakovë. Andaj, për arsyet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nenit 72 të Rregullave te Prokurim Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit ligjorë të përcaktuar me ligj.

Ardian Gjini



Kryetari i Komunës



Faton Gutaj



Zyrtar përgjegjës i prokurimit

Vendimi t'i dorëzohet:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Drejtorisë për Arsim
Drejtorisë për Buxhet dhe financa
Menaxherit të kontratës;
Arkivës së Komunës.